

Presidenca: Kryetari i ri i Kuvendit do ta marrë pozitën e ushtruesit të detyrës së presidentit | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJASHTË 'JO' QË TESTOJNË TË ARDHMEN E LDK-së

| FAQE 4-5



Gjashtë deputetë, një marrëveshje e refuzuar dhe një parti që po përballet me një nga përplasjet më serioze të brendshme në vitet e fundit. Vendimi i gjashtë deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës

(LDK) për të mos e mbështetur marrëveshjen e partisë së tyre me Lëvizjen Vetëvendosje (LV) për zgjedhjen e Bekim Sejdiut president nuk ka vënë në pikëpyetje vetëm fatin e kësaj marrëveshjeje. Ai ka nxjerrë në

sipërfaqe ndarjet brenda LDK-së, ka shtuar mundësinë që Kosova të përfundojë sërish në zgjedhje dhe ka ngritur një pyetje më të madhe për vetë partinë: sa e bashkuar mund të dalë prej kësaj krize?

IKD: LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA E ORGANEVE KOLEGJIALE MBETEN PENG I LPPA-së F. 7



'MOSRESPEKTIMI I KUSHTETUTËS, SIMPTOMË E PUSHTETIT ANARKIK' - PDK DHE ALEANCA PËRSËRISIN THIRRJEN PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT F. 3



AKTUALE



RUBIO KONFIRMON BISEDIMET ME UKRAINËN PËR 'PATRIOTËT', EKSPERTËT PARALAJMËROJNË SE PRODHIMI ËSHTË VITE LARG F. 2

ARRESTOHET NJË PERSON, I DYSHUAR PËR KRIME LUFTE NË ZUBIN POTOK F. 6

NATO RIORGANIZON KFOR-IN NË KOSOVË, AMBASADA E SHBA-së: PROCESI DO TË BËHET NË KOORDINIM ME PALËT F. 6

EKONOMI



AVOKATI I POPULLIT: KRITERET E QEVERISË PËR PAGËN E 13 CENOJNË BARAZINË DHE PRITSHMËRINË LEGJITIME F. 7

ASK DHE UNIONI I TURIZMIT NË KOSOVË NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR AVANCIMIN E STATISTIKAVE TË TURIZMIT F. 8

SPORT



KOSOVA MBYLL 'TARANTO 2026' ME REKORD MEDALJESH F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

RUBIO KONFIRMON BISEDIMET ME UKRAINËN PËR ‘PATRIOTËT’, EKSPERTËT PARALAJMËROJNË SE PRODHIMI ËSHTË VITE LARG

UASHINGTON, 3 SHTATOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka konfirmuar se Uashingtoni dhe Kievi po negociojnë për një licencë që do t'i mundësonte Ukrainës të prodhonte raketa për sistemin amerikan të mbrojtjes ajrore “Patriot”, duke rikthyer në vëmendje një ide të cilën presidenti Donald Trump dukej se e kishte minimizuar vetëm disa javë më parë.

Komentet e Rubios i ofrojnë Ukrainës një rrugë të mundshme afatgjatë drejt një vetëqëndrueshmërie më të madhe në mbrojtjen ajrore. Por, ai e bëri të qartë se edhe nëse licenca miratohet, ajo nuk do ta zgjidhte mungesën e menjëhershme të penguesve që i nevojiten Kievit. “Po negociohet pikërisht në këtë moment”, tha Rubio më 2 shtator, kur u pyet në emisionin “The Brian Kilmeade Show” nëse ishte kundër dhënies së licencave Ukrainës për të prodhuar raketat e veta ‘Patriot’.

“Por, kjo nuk është zgjidhje e menjëhershme”, shtoi ai, duke thënë se “rritja e prodhimit” dhe ndërtimi i fabrikave për armë kaq të sofistikuara do të kërkonte disa vjet.

Komentet erdhën në një kohë kur Ukraina po kërkon më shumë pengues për mbrojtjen ajrore, përpara një tjetër dimri me sulme ruse me raketa dhe dronë. Rubio tha se kërkesa për raketa penguese është bërë “nevoja numër një e mbrojtjes në planet”, ndërsa edhe vendet e Lindjes së Mesme po kërkojnë të sigurojnë këto sisteme.

Megjithatë, ai theksoi se Shtetet e Bashkuara kanë nevojat e tyre të mbrojtjes dhe duhet të ruajnë rezerva të mjaftueshme përpara se t'i furnizojë vendet e tjera.

Për Kievin kjo lë një boshllëk të vështirë: raketat penguese nevojiten tani, ndërsa kapaciteti industrial që po diskutohet mund të kërkojë vite për t'u krijuar.

Asnjë zgjidhje me “Patriotë” për këtë dimër

Konfirmimi i Rubios nuk garanton se do të arrihet marrëveshje dhe nuk ofron ndonjë zgjidhje të shpejtë për nevojat e menjëhershme të Ukrainës për mbrojtje ajrore.

Admirali në pension Mark Montgomery, drejtor i lartë në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive, i tha Radios Evropa e Lirë se prodhimi ukrainas i Patriotëve do të ishte i dobishëm, por nuk do të kishte ndikim të rëndësishëm në luftë në një afat të afërt. “Ideja që ShBA-ja do të punojë me Ukrainën që ajo përfundimisht

të licencojë dhe të prodhojë ‘Patriotë’ është e admirueshme, por kjo është vite larg”, tha Montgomery.

Ai vlerësoi se licencimi dhe krijimi i kapaciteteve të prodhimit mund të kërkojnë të paktën 18 muaj dhe potencialisht dy ose tre vjet. “Kjo nuk do të prodhojë ‘Patriotë’ për Ukrainën në vitin 2026 apo 2027, ndoshta as në vitin 2028”, tha ai.

“Pra, edhe pse kjo është interesante, nuk do ta ndryshojë status quo-në e konfliktit me Rusinë”.

Montgomery tha se nuk beson se Shtetet e Bashkuara po i ofrojnë aktualisht Ukrainës numër të mjaftueshëm sistemesh “Patriot”, gjë që, sipas tij, mund ta bëjë dimrin e ardhshëm të vështirë.

Në vend të kësaj, ai sugjeroi mënyra se si Uashingtoni mund ta ndihmojë Ukrainën t'i godasë raketat ruse përpara se ato të lëshohen. Ai sugjeroi dhënien e të dhënave të shënjestritimit që do t'u mundësonin dronëve ukrainas me rreze të mesme t'i godisin sistemet ruse të lëshimit të raketave balistike Iskander si dhe përmirësime softuerike për avionët ukrainas F-16, në mënyrë që ata të mund t'i shënjestrojnë në kohë reale këto sisteme lëshimi.

Një sinjal për Kievin dhe Moskën

Megjithatë, bisedimet për licencimin kanë rëndësi politike dhe strategjike.

Yevheniy Malik, veteran i Marinës ukrainase dhe mbrojtës i Mariupolit, i cili drejton programet për sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen në Shkollën e Ekonomisë në Kiev, u pajtua se krijimi i një kapaciteti ukrainas për “Patriotët” do të ishte një proces afatgjatë. Por, ai tha se rëndësia qëndron edhe te sinjali se Uashingtoni po vazhdon të punojë me Kievin për kapacitete të avancuara mbrojtëse. “Është më shumë çështje e sinjalit”, i tha Malik Radios Evropa e Lirë.

Për ukrainasit dhe amerikanët e zakonshëm, tha ai, detajet teknike të penguesve të raketave balistike mund të jenë të vështira për t'u kuptuar. Ajo që është më e lehtë për t'u parë është bashkëpunimi mes Shteteve të Bashkuara dhe Ukrainës dhe mesazhi më i gjerë i mbështetjes nga aleatët.

Rusia po e vëzhgon gjithashtu këtë marrëdhënie, tha Malik.

Diskutimet për “Patriotët” vijnë paralelisht me bisedimet ShBA - Ukrainë për teknologjinë e dronëve. I pyetur nëse Uashingtoni kishte hezituar ta pranonte ofertën e Ukrainës për



teknologjinë e dronëve, Rubio tha se Shtetet e Bashkuara po ndjekin marrëveshje që kanë kuptim për to. “Nëse është një marrëveshje që ka kuptim për ShBA-në, mendoj se po punojmë për to”, tha Rubio, duke i përshkruar diskutimet si “një proces në zhvillim”. Ai përsëri theksoi se projekte të tilla do të ishin përpjekje afatgjata dhe jo kapacitete që mund të bëhen funksionale menjëherë.

Këto diskutime tregojnë kështu drejt një forme më të gjerë të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, në të cilën Ukraina përfundimisht mund të bëhet jo vetëm përfutuese e armëve perëndimore, por edhe burim i teknologjisë ushtarake të testuar në fushëbetejë.

Matematika e frikshme e prodhimit

Edhe nëse Ukraina merr një licencë, shkalla e kërcënimit nga raketat balistike paraqet një sfidë të jashtëzakonshme.

Malik tha se Rusia mund të prodhojë rreth 1 000 ose më shumë raketa balistike në vit, ndërsa prodhimi amerikan i interceptorëve PAC-3 Patriot është pak mbi 600 në vit. Pabarazia bëhet edhe më e theksuar pasi ndalja e një rakete balistike nuk kërkon domosdoshmërisht vetëm një raketë penguese.

Malik iu referua vlerësimeve ukrainase, sipas të cilave, mund të nevojiten dy raketa PAC-3 për të penguar një raketë balistike, në skenarët më optimistë, ndërsa vlerësime të tjera e vendosin numrin në tre ose edhe 3.5. Kjo tregon se një kapacitet ukrainas prodhimi do të duhej të arrinte një shkallë të konsiderueshme për të ndikuar ndjeshëm në ekuilibrin.

Raketat e Koresë së Veriut që Rusia po i përdor kundër Ukrainës

Malik gjithashtu iu referua bashkëpunimit ushtarak të Rusisë me Korenë e Veriut dhe Iranin, përfshirë përdorimin e raketave balistike të Koresë së Veriut kundër Ukrainës.

Argumenti i tij më i gjerë është se nevojat e ardhshme të Kievit për mbrojtjen ajrore duhet të maten në raport me një kërcënim më të gjerë dhe potencialisht në rritje nga raketat balistike.

Kievi përballat me një rrugë edhe më të gjatë

Kateryna Bondar, bashkëpunëtore e lartë në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare dhe ish-këshilltare e qeverisë ukrainase, është skeptike për çdo ndikim në një afat të afërt.

Bondar u kthye së voni nga Ukraina, ku foli me specialistë ukrainas të raketave për perspektivat e prodhimit vendas të Patriotëve. Ajo i tha Radios Evropa e Lirë se specialistët ukrainas me të cilët foli vlerësuan se mund të duheshin “deri në pesë, gjashtë vjet vetëm për të filluar prodhimin”, për shkak të kompleksitetit të sistemit.

Edhe prodhuesit e konsoliduar përballen me kufizime të mëdha në rritjen e prodhimit.

Bondar tha se ekspertët e Lockheed Martin i kishin thënë se, pavarësisht prej teknologjisë ekzistuese, zinxhirëve të furnizimit, partnerëve të prodhimit dhe infrastrukturës tjetër, rritja e prodhimit nga rreth 600 pengues PAC-3 në të paktën 2 000 mund të kërkojë rreth tre vjet.

Për Ukrainën, e cila do të duhej

të krijonte një pjesë të madhe të bazës industriale, sfida do të ishte edhe më e madhe. “Pra, kjo nuk do ta ndryshojë llogaritjen në asnjë perspektivë afatshkurtër dhe madje as në atë afatmesme”, tha Bondar.

Megjithatë, ajo sheh një qëllim potencialisht të rëndësishëm në afat të gjatë.

Disa ukrainas gjithnjë e më shumë e shohin qasjen në raketa të avancuara penguese si pjesë të një garancie të ardhshme të sigurisë, tha ajo. Një kapacitet i besueshëm për t'u mbrojtur nga raketat balistike ruse mund ta ndihmojë në parandalimin e Moskës që të nisë një luftë të gjerë përsëri pas një armëpushimi ose marrëveshjeje paqeje. “Të kesh pengues, të kesh aftësinë për t'i penguar raketat balistike ruse, është diçka që mund ta ndalojë Rusinë të përparojë”, tha Bondar.

Moska mund të mos presë

Bondar tha se disa ekspertë ukrainas kanë frikë se Moska mund ta përshpejtojë prodhimin e raketave balistike dhe të zhvillojë kundërmasa përpara se Ukraina të sigurojë teknologjinë dhe infrastrukturën e nevojshme për të prodhuar pengues PAC-3.

“Rusët padyshim po e kuptojnë porosinë”, tha Bondar. “Ata jo vetëm që po e kuptojnë. Ata tashmë kanë filluar të mendojnë për kundërmasat”.

Kjo mund ta shndërrojë përpjekjen për licencim në pjesë të një gare më të gjatë teknologjike. Ndërsa Kievi dhe Uashingtoni përpiqen të krijojnë një kapacitet të qëndrueshëm të mbrojtjes ajrore, Moska mund të kërkojë ta rrisë prodhimin e raketave ose të zhvillojë mënyra për ta mbingarkuar atë.

'MOSRESPEKTIMI I KUSHTETUTËS, SIMPTOMË E PUSHTETIT ANARKIK'

- PDK DHE ALEANCA PËRSËRITIN THIRRJEN PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), së bashku me ata të Aleancës, edhe këtë të enjte i janë përmbajtur afatit 48-orësh, aq sa parashihet me Rregulloren e Punës së Kuvendit për ndërprerjen e seancës konstituive. Sikurse edhe në herët e kaluara, deputetët janë futur në sallën e Kuvendit e aty kanë përsëritur thirrjet për konstituimin e legjislaturës së 11-të.

Deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, ka përkujtuar se gjatë vitit 2025 Lëvizja Vetëvendosje propozonte kryetarë të Kuvendit çdo 48 orë, edhe pse nuk i kishte votat e nevojshme, ndërsa tani, sipas tij, ndonëse i ka votat, nuk po bën një propozim të tillë. "Logjika është e njëjtë, me e blloku Kosovën. Imagjinoni, nuk i kishte votat, vinte për të propozuar, sot që i ka votat nuk vjen për të propozuar fare. Afatet e përcaktuara në Kushtetutë janë të qarta dhe nuk janë zbulurim, por janë pjesë thelbësore", ka deklaruar Gruda në seancën e thirrur nga PDK-ja.

Ai ka thënë se nuk mund të pritët që shoqëria t'i respektojë ligjet nëse afatet nuk respektohen në Kuvend. "Imagjinojeni po që se shkollat mos të fillojnë me 1 shtator, ose mësuesit të shkojnë tri orë më vonë në punë, mjekët të mos dalin me kohë në punë ose policët mos të dalin në trafik. Kjo do të ishte një kaos", ka shtuar ai. "Mosrespektimi i Kushtetutës në Kuvend është simptoma e një pushteti anarkik", ka thënë Gruda.

Ndërkaq, deputetja e Aleancës, Albana Bytyqi, ka thënë se Kosova po përballët me shumë probleme që kërkojnë zgjidhje konkrete. "Detyra jonë në Kuvend është t'i trajtojmë problemet e qytetarëve dhe ta bëjmë zgjidhjen e tyre", ka deklaruar ajo. Bytyqi ka thënë se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i ka marrë peng institucionet ndërsa, sipas saj, ka harruar t'u kushtojë vëmendje dhe të ofrojë zgjidhje për kërcënimet që lidhen me Ujmanin. "Deklaratat e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, për Ujmanin nuk mund të trajtohen si deklarata të zakonshme

politike", ka shtuar ajo. Deputetët e PDK-së dhe të Aleancës nuk janë përfshirë në bisedimet për zgjedhjen e kandidatit për president, por kanë vazhduar të bëjnë thirrje për konstituimin e institucioneve. Seanca konstituive e legjislaturës së 11-të ka nisur më 6 gusht 2026 dhe ka vazhduar më 8 gusht, por prej atëherë nuk është vazhduar më.

PDK-ja në vazhdimësi i ka dërguar letra kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, për vazhdimin e seancës, por ai ka refuzuar ta bëjë një gjë të tillë pa një marrëveshje politike mes partive për zgjidhjen e çështjes së presidentit.

Në aktgjykimin e 26 qershorit 2025, Gjykata Kushtetuese kishte përcaktuar se procedura e konstituimit duhet të përfundojë brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve zgjedhore dhe se Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar pa zgjedhjen e organeve të tij drejtuese.

Ndërkohë, është tejkaluar edhe afati 48-orësh i përcaktuar me

Rregulloren e Kuvendit si maksimumi i lejuar për ndërprerjen e seancës. Pavarësisht prej kësaj, seanca konstituive ende nuk ka përfunduar, ndërsa përplasjet politike vazhdojnë ta pengojnë formimin e institucioneve të reja.

Kurti: Marrëveshja me LDK-në ka marrë goditje, por nuk është zhvlerësuar

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se marrëveshja politike mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës ka marrë një goditje të rëndë. Pavarësisht kësaj, ai ka konsideruar se marrëveshja nuk është zhvlerësuar. "Ata që e duan stabilitetin institucional, evitimin e zgjedhjeve, forcimin e shtetit, e kanë shansin, e kjo është emri i përveçshëm që ka dalë nga marrëveshja politike, përkatësisht profesor Bekim Sejdiu", ka thënë Kurti për Ekonomia Online.

Një ditë më herët, pas një takimi me deputetët e partive të komuniteteve joshumicë, Kurti ka deklaruar se me ta ka biseduar për mundësinë e shmangies së zgjedhjeve të reja, pas marrëveshjes së arritur mes LV-së dhe LDK-së për Bekim Sejdiun si kandidat për president.

Ky takim është zhvilluar pas një takimi që Kurti kishte pasur paraprakisht me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku. "Ky takim me grupin multietnik është aranzhuar më herët. I njoftova për bisedimet që kam pasur, për marrëveshjen politike që kemi bërë me LDK-në për emrin e përveçëm të presidentit, për profesor Bekim Sejdiun. Ata ndajnë keqardhjen me të gjithë neve që kjo nuk po mund të realizohet për shkak se gjashtë deputetë nga LDK-ja nuk e respektojnë këtë marrëveshje, ndonëse dakordimi ka qenë që të negociohet me vullnet të mirë", ka thënë Kurti.

Pas takimit me Abdixhikun, Kurti nuk ka folur për medie. Për këtë takim ai ka thënë se ishte informuar nga Abdixhiku për situatën aktuale në LDK.


Ekzekutohen pagat e deputetëve, Sadiku: 1 500 euro pagë me dy seanca të çuditshme, për besë keq

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ermal Sadiku, ka reaguuar lidhur me punën e Kuvendit pasi sot janë ekzekutuar pagat e deputetëve. Sadiku në rrjetin social

"Facebook" ka bërë me dije se deputetët që janë betuar në Kuvend kanë marrë pagat, ndërsa ai personalisht ka deklaruar se kjo është paga e katërt që merr nga Kuvendi. "Sa për info: deputetët që jemi betuar në Kuvend i kemi marrë rrogat. Për mua, kjo është rroga e katërt që e

marrë nga Kuvendi. Rrogat kalimtare nuk i kam marrë. 1,500 euro rrogë, me dy seanca të çuditshme, është për besë keq. E di që po tingëllojë pak si popullistët që i urrej, por gjatë gjithë kësaj kohe kemi mundur të punojmë në komisione, t'i shtyjmë përpara disa ligje që

po presin, të diskutojmë e të propozojmë politika dhe, në fund të fundit, t'i kryejmë punët për të cilat na kanë votuar qytetarët. Thirrreni seancën, të pa dashtun e të parespektuar Vetëvendosje. Lërimi këto dallavere, bllokada e manipulime", ka shkruar Sadiku.





GJASHTË ‘JO’ QË TESTOJNË TË ARDHMEN E LDK-së

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Gjashtë deputetë, një marrëveshje e refuzuar dhe një parti që po përballlet me një nga përplasjet më serioze të brendshme në vitet e fundit.

Vendimi i gjashtë deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për të mos e mbështetur marrëveshjen e partisë së tyre me Lëvizjen Vetëvendosje (LV) për zgjedhjen e Bekim Sejdiut president nuk ka vënë në pikëpyetje vetëm fatin e kësaj marrëveshjeje. Ai ka nxjerrë në sipërfaqe ndarjet brenda LDK-së, ka shtuar mundësinë që Kosova të përfundojë sërish në zgjedhje dhe ka ngritur një pyetje më të madhe për vetë partinë: sa e bashkuar mund të dalë prej kësaj krize?

Vëzhguesit politikë nuk janë të sigurt nëse përplasia mund të përfundojë me një ndarje formale të LDK-së. Por, për një gjë pajtohen: dëmi politik për partinë tashmë është real. Deputetët Avdullah Hoti, Hykmete Bajrami, Kujtim Shala, Armend Zemaj, Arben Gashi dhe Janina Ymeri refuzuan ta mbështesin marrëveshjen me LV-në, duke dalë kundër qëndrimit të Kryesisë së LDK-së. Kryetari i partisë, Lumir Abdixhiku, e cilësoi vendimin e tyre dëm “të pariparueshëm ndaj gjithë procesit” dhe paralajmëroi se ai mund ta çojë vendin në zgjedhje të

parakohshme parlamentare. Pavarësisht prej kundërshtimit të gjashtë deputetëve, kreu i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se marrëveshja me LDK-në mbetet në fuqi.

Një parti, dy kampe?

Për analistin Artan Muhaxhiri ndarja në LDK tashmë ekziston - edhe nëse ende nuk është formalizuar. “LDK-ja tashmë është e ndarë ideologjikisht. Janë evidente dy mënyra të të menduarit politik, të kundërta në aspektin e raportit ndaj përgjegjësisë për trashëgiminë e partisë dhe trajektore të ardhmërisë”, thotë Muhaxhiri për Radion Evropa e Lirë. Përgjegjësinë kryesore për këtë situatë ai ia atribuon Abdixhikut. Sipas Muhaxhirit, para se ta arrinte marrëveshjen me LV-në, kreu i LDK-së duhej t’i përfshinte në diskutime deputetët që mendonin ndryshe dhe të kërkonte “modalitete përbashkuese” në vend se t’i vendoste ata para një akti të kryer.

Edhe analisti Yll Hoxha e sheh përplasjen e fundit si simptomë të një problemi më të thellë. Ai rikujton se udhëheqja e Abdixhikut është sfiduar dy herë me votë brenda partisë në më pak se një vit dhe se, pavarësisht se u mbijetoi të dyja sfidave, ai nuk arriti ta rikthejë kohezionin

në LDK.

Pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025, në të cilat LDK-ja mori 13 për qind të votave dhe doli e treta, Abdixhiku kërkoi votëbesimin e partisë në janar të vitit 2026 dhe e mori atë.

Në korrik, pas kërkesave të një grupi anëtarësh të LDK-së për dorëheqjen e tij, të cilat pasuan zgjedhjet e 7 qershorit, pozita e Abdixhikut u vu sërish në provë. Edhe këtë herë ai e ruajti drejtimin e partisë.

Por, për Hoxhën, përplasia e fundit tregon se konflikti nuk është kapërcyer. Ai nuk beson se kundërshtimi i gjashtë deputetëve ka të bëjë vetëm me kandidaturën e Bekim Sejdiut. Sipas tij, ai është, para së gjithash, një refuzim i lidershipit të vetë LDK-së. “Unë nuk jam i sigurt që këto përçarje do ta ndajnë LDK-në, por se do ta dëmtojnë, jam gjithsesi i sigurt. Diçka që mund të jetë në interes të LDK-së po mohohet [nga gjashtë deputetët], duke i dhënë primat rivalitetit të brendshëm”, thotë Hoxha për Radion Evropa e Lirë.

Nga përplasia e brendshme tek akuzat publike

Konflikti nuk ka mbetur vetëm brenda strukturave të partisë. Pas refuzimit të marrëveshjes, Abdixhiku dhe disa nga deputetët kundërshtues dolën

publikisht me qëndrime të kundërta.

Abdixhiku tha se me mosmbështetjen e kandidaturës së propozuar nga LDK-ja është përcaktuar edhe “fati i vendit - zgjedhje të reja”. Avdullah Hoti, ndërkaq, tha se kandidatura e Sejdiut “nuk pasqyron interesat politike dhe parimore të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe elektoratit të saj”.

Hykmete Bajrami e kundërshtoi marrëveshjen nga një kënd tjetër. “Për mua është e papranueshme që sot, në emër të zgjidhjes së krizës institucionale, të bëhemi pjesë e një marrëveshjeje që ia zgjat pushtetin e koncentruar Albin Kurtit”, tha ajo. Radio Evropa e Lirë u përpoq gjatë së mërkurës t’i kontaktonte gjashtë deputetët për t’i pyetur nëse refuzimi i tyre mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja dhe kush do ta bartte përgjegjësinë për këtë, por asnjëri nuk u përgjigj.

A e çon përplasia vendin në zgjedhje?

Pasojat e krizës në LDK mund të shkojnë përtej vetë partisë. Për zgjedhjen e presidentit kërkohet pjesëmarrja e së paku 80 prej 120 deputetëve të Kuvendit të Kosovës në votim. Në dy rundet e para nevojiten

80 vota, ndërsa në të tretin 61, me së paku 80 deputetë të pranishëm në sallë. Nëse presidenti nuk zgjidhet as në rundin e tretë, Kuvendi shpërndahet dhe zgjedhjet e reja duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

LV-ja ka 53 mandate, ndërsa LDK-ja 18.

Por, pas kundërshtimit të gjashtë deputetëve, sipas Abdixhikut, vetëm 12 deputetë të LDK-së janë të gatshëm ta mbështesin Sejdiun.

Edhe nëse kësaj llogarie i shtohen deputetët e komuniteteve joserbe që kanë bashkëpunuar me LV-në, numri mbetet nën pragun e nevojshëm.

Partia Demokratike e Kosovës ka deklaruar se do të mbetet në opozitë dhe nuk do ta mbështesë marrëveshjen me Kurtin, ndërsa Aleanca ka vendosur kushte për mbështetjen e institucioneve. Abdixhiku ka shkuar edhe më tej në kritikën ndaj gjashtë deputetëve.

Ai tha se ata që nuk respektojnë vendimin e Kryesisë së LDK-së, “nëse asgjë tjetër, do të duhej ta dorëzonin mandatin e deputetit”, ndonëse shtoi se nuk ua ka kërkuar një gjë të tillë. Për Muhaxhirin, përgjegjësia për rrezikun e dështimit të procesit nuk mund t’u faturohet vetëm gjashtë

PRESIDENCA: KRYETARI I RI I KUVENDIT DO TA MARRË POZITËN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË PRESIDENTIT

PRISHTINE, 3 SHTATOR - Pozitën e ushtruesit të detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, do t'ia dorëzojë kryetari të ri të Kuvendit që do të zgjidhet nga legjislatura e njëmbëdhjetë. Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, nga Presidenca e Kosovës thanë se vendi nuk mund të mbetet pa ushtrues detyre të presidentit. “Me zgjedhjen e kryetarit të ri të Kuvendit, kushdo qoftë ai apo ajo, ushtrimi i detyrës së presidentit kalon te kryetari i ri i Kuvendit deri në zgjedhjen e presidentit të Republikës”, tha

Presidenca në një përgjigje për REL-in. Legjislatura e re, e dalë nga zgjedhjet e qershorit, ende nuk është konstituuar. Seanca konstituive, që nisi më 6 gusht, nuk është përmbyllur, pasi Lëvizja Vetëvendosje kërkon që fillimisht të ketë pajtim për zgjedhjen e presidentit të vendit. Haxhiu ushtron detyrën e presidentit që nga 4 prilli, si kryetare e legjislaturës së dhjetë të Kuvendit, pas përfundimit të mandatit pesëvjeçar në krye të shtetit të Vjosa Osmanit. Sipas Kushtetutës së Kosovës, posti i ushtruesit të detyrës së

presidentit nuk mund të ushtrohet më gjatë se gjashtë muaj. Në rastin e Haxhiut ajo mund ta ushtrojë këtë post deri më 4 tetor. Nga Presidenca e Kosovës e lanë të hapur mundësinë që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për sqarim nëse deri më 4 tetor deputetët nuk zgjedhin një president të ri të shtetit. “Në këtë fazë nuk do të paragjykonim nëse do të paraqitet nevoja për një procedurë të tillë”, thuhet në përgjigjen e Presidencës. Megjithatë, sipas këtij institucioni, aktualisht fokusi

duhet të jetë te zgjedhja e një presidenti me mandat të plotë. Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës në fillim të kësaj jave arritën marrëveshje për çështjen e presidentit. Dy partitë propozuan Bekim Sejdiun, ish-gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, për postin e presidentit. Por, një ditë më vonë, marrëveshja nuk u përkrah nga gjashtë deputetë të LDK-së, duke ngritur pikëpyetje nëse ajo mund ta prodhojë kreun e ri të shtetit. Pas këtij zhvillimi, kreu i LV-së, njëherësh kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha

se do të vazhdojnë përpjekjet për çështjen e presidentit, duke shtuar se tani janë 74 vota për Sejdiun. Për zgjedhjen e presidentit kërkohej pjesëmarrja e së paku 80 deputetëve në votim nga 120 sa i ka gjithsej Kuvendi i Kosovës. Në dy raundet e para nevojiten 80 vota, ndërsa në të tretin 61, me së paku 80 deputetë të pranishëm në sallë. Nëse presidenti nuk zgjidhet as në raundin e tretë, sipas Kushtetutës, Kuvendi shpërndahet dhe zgjedhjet e reja duhet të mbahen brenda 45 ditësh.



deputetëve. Ai ia atribuon atë LV-së dhe kreut të LDK-së. “Përgjegjësia e tyre për bërjen publike të një marrëveshjeje të pabazuar në realitet është etapa e fundit e rrugëtimit drejt zgjedhjeve të reja”, thotë Muhaxhiri. Hoxha e sheh përgjegjësinë më gjerë. Sipas tij, ngërçi aktual është vetëm një në serinë e krizave politike dhe institucionale me të cilat Kosova është përballur gjatë dy vjetëve të fundit. “Përgjegjësinë për këtë ngërç dhe për këtë paafësi të zgjedhjeve e bart e gjithë skena politike, pa përjashtim, në bazë të hierarkisë, në bazë të pushteteve dhe mbështetjeve që kanë”, thotë ai. Megjithatë, Hoxha pajtohet se përplasja brenda LDK-së mund të jetë pikërisht shkak i

shtyn vendin drejt zgjedhjeve të parakohshme.

Me çfarë LDK-je në zgjedhje?

Nëse kjo ndodh, beteja e radhës për LDK-në nuk do të jetë vetëm kundër rivalëve politikë. Ajo do të duhet të hyjë në zgjedhje duke bartur edhe konfliktin e vet të brendshëm. Hoxha beson se një proces i ri zgjedhor, i shkaktuar nga dështimi për zgjedhjen e presidentit, do ta dëmtonte gjithë establishmentin politik. Por LDK-ja, sipas tij, do të hynte në të veçanërisht e hendikepuar. “Këtë herë do të jetë e hendikepuar edhe nga narrativi se si hyn në zgjedhje, sepse do të hynte si mjaft fajtores për një proces, të cilin vetë e inicioi. Zgjedhja e Bekim Sejdiut ishte

iniciativë e LDK-së. Dështimi i këtij procesi për shkak të përçarjeve të brendshme i jep një barrë të fajt të theksuar LDK-së”, thotë Hoxha. Muhaxhiri është edhe më kritik ndaj mënyrës se si Abdixhiku e ka menaxhuar krizën. Sipas tij, “Abdixhiku brutalisht e lëndoi LDK-në, duke u dhuruar argumente të bollshme armiqve politikë për të përfituar nga çarja e krijuar”. Ai paralajmëron se, nëse Kosova shkon në zgjedhje dhe Abdixhiku “zgjedh kryeneçësinë” në raport me deputetët që kundërshtuan marrëveshjen, LDK-ja rrezikon të shndërrohet në një “parti me elektorat njëshifror”. “LDK-ja do të ishte gati inekzistente, ka për të pasur ndikim minimal në skenën politike dhe do t'u shërbejë partive tjera për të rritur elektoratin”, thotë

Muhaxhiri. Një dobësim i tillë, sipas tij, do të kishte pasojat edhe përtej vetë LDK-së. “Kjo do të ishte zhgënjyese jo vetëm për elektoratin, por do ta dëmtonte edhe spektrin politik në Kosovë, sepse ka qenë pjesë e të gjitha proceseve shtetndërtuese, ka mbajtur dhe mund të mbajë një rol të veçantë në spektrin politik si një balancuese. Por, kjo mbetet në vullnetin e liderit të saj, veçanërisht të kryetarit Abdixhiku”, thotë Muhaxhiri.

Një precedent që LDK-ja e njej

Për LDK-në një konflikt i brendshëm që përfundon me ndarje nuk është skenar i panjohur. Muhaxhiri thotë se partia duhet

ta ketë parasysh atë që ai e quan “leksioni nga viti 2006”. Pas vdekjes së liderit historik të LDK-së, Ibrahim Rugova, partia u përfshi në një betejë të ashpër për drejtimin e saj. Gara mes Fatmir Sejdiut dhe Nexhat Daci kulmoi në dhjetor të vitit 2006 me zgjedhjen e Sejdiut kryetar. Por, përplasjet mes dy kampeve nuk përfunduan aty. Daci, tashmë i ndjerë, u largua nga LDK-ja dhe në vitin 2007 krijoi Lidhjen Demokratike të Dardanisë. Pothuajse dy dekada më vonë, askush nuk mund të thotë nëse përplasia e sotme do ta çojë LDK-në deri në një ndarje të re. Por, edhe pa arritur deri aty, partia përballet me një dilemë më të menjëhershme: si të kërkojë unitet nga elektorati nëse nuk arrin ta gjejë atë brenda vetes?!

Mbi 15 mijë shërbime radiologjike u realizuan gjatë gushtit në QKUK

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Në Klinikën e Radiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), gjatë muajit gusht 2026 janë realizuar gjithsej 15 272 shërbime radiologjike, duke dëshmuar një aktivitet të lartë

në diagnostikë dhe radiologji intervente. Shërbimet e ofruara kanë përfshirë një gamë të gjerë ekzaminimesh dhe procedurash diagnostikuese, ndër to radiografinë (RTG), ultratingullin, tomografinë e

kompjuterizuar (TK), rezonancën magnetike (RM), si dhe procedura të radiologjisë intervente. Nga numri i përgjithshëm i shërbimeve, 8 468 ekzaminime janë realizuar përmes radiografisë (RTG), 2 742

përmes ultratingullit, 2 824 përmes tomografisë së kompjuterizuar (TK), ndërsa 1 111 ekzaminime përmes rezonancës magnetike (RM). Po gjatë këtij muaji janë realizuar edhe 127 procedura të radiologjisë intervente.



ARRESTOHET NJË PERSON, I DYSHUAR PËR KRIME LUFTE NË ZUBIN POTOK

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Një person është arrestuar për krime lufte dhe është dërguar në ndalim për 48 orë, ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës. I dyshuari R. K. është arrestuar në kuadër të hetimeve që po zhvillohen për krime lufte në Zubin Potok. Ai dyshohet për veprën penale “Krime lufte kundër popullatës civile”. Në tri varreza masive në këtë komunë në veri të Kosovës janë gjetur mbetjet mortore të së paku 23 personave. Lidhur me gjetjen e varrezave masive, autoritetet më herët kanë njoftuar për arrestimin e tre personave të tjerë të cilët gjenden në paraburgim. Prokuroria Speciale tha se brenda afatit ligjor do ta kërkojë caktimin e masës së paraburgimit edhe për R. K. Në Kalludër të Vogël dhe Jabukë të Zubin Potokut gjermimet nisën në korrik dhe



më 21 gusht autoritetet njoftuan për përfundimin e procesit të gjurmimeve dhe zhvarrosjeve të mbetjeve mortore në tri lokacione. Dhjetë mbetje kockore,

ndërkaq, veçse janë dërguar në Hagë për identifikim përmes ADN-së. Autoritetet në Kosovë dyshojnë se mbetjet mortore të gjetura në varrezat masive

në Kalludër të Vogël dhe në Jabukë të Zubin Potokut mund t'i përkasin “grupit të intelektualëve të Mitrovicës”. Grupi prej 23 personash është i zhdukur që nga 19 prilli i vitit

1999. Në mesin e tyre kishte mjekë, profesorë, avokatë dhe profile të tjera. Prokuroria Speciale ka thënë se rasti i 23 personave të zhdukur është trajtuar që shtatë vjet dhe provat e mbledhura deri tani çojnë hetimin drejt tyre, por vetëm përmes identifikimit me ADN do të vërtetohet nëse bëhet fjalë për ta. Sipas Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, 1 577 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-1999, ndërsa janë dokumentuar gjithsej 12 230 viktima të luftës. Kosova ka kërkuar vazhdimisht nga Serbia bashkëpunim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe qasje në arkivat ushtarake që sipas autoriteteve mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme.

NATO RIORGANIZON KFOR-in NË KOSOVË, AMBASADA E SHBA-së: PROCESI DO TË BËHET NË KOORDINIM ME PALËT

PRISHTINË, 3 SHTATOR - NATO është duke ndërmarrë një proces gradual për optimizimin e pozicionimit të forcave të KFOR-it në Kosovë, ndërsa Shtetet e Bashkuara kanë thënë se ky proces do të zhvillohet në koordinim të ngushtë me të gjithë aktorët relevantë. Për këtë çështje, Ambasada e ShBA-së në Prishtinë i është përgjigjur “Telegrafit”, duke theksuar se prioriteti i Uashingtonit mbetet stabiliteti rajonal në Ballkanin Perëndimor. “NATO aktualisht është duke ndërmarrë një optimizim të pozicionimit të forcave të misionit të KFOR-it. Procesi do të jetë gradual dhe i koordinuar ngushtë me të gjithë aktorët relevantë”, ka thënë një zëdhënës i Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë. Ambasada Amerikane ka theksuar se gjatë këtij procesi do

të vazhdojë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të sigurisë së Kosovës, KFOR-it, EULEX-it dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. “Presim vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të sigurisë së Kosovës, KFOR-it, EULEX-it dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë gjatë gjithë procesit të optimizimit të pozicionimit të forcave të NATO-s”, është thënë në përgjigje. Në deklaratën për “Telegrafin”, ShBA-ja e ka vënë theksin edhe te rëndësia e ruajtjes së stabilitetit në rajon. “Shtetet e Bashkuara i japin përparësi ruajtjes së stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Ne e vlerësojmë përkushtimin e KFOR-it për të mbështetur një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm që siguron siguri



afatgjatë për të gjitha komunitetet”, ka thënë zëdhënësi. Deklarata vjen në kohën kur KFOR-i ka njoftuar për

ndryshime në pozicionimin e forcave të tij në Kosovë, përfshirë edhe çështjen e pranisë në urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë.

KFOR-i e ka bërë të qartë se vendimi për hapjen e urës për qarkullim nuk i takon këtij misioni, por Bashkimit Evropian dhe institucioneve të Kosovës.

Inspektime në shtatë qytete për shitjen e cigareve pranë shkollave, shqiptohen gjoba dhe sekuestrohen produkte

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), ka zhvilluar inspektime në terren lidhur me shitjen e cigareve dhe cigareve elektronike në afërsi të institucioneve arsimore.

Gjatë aksionit janë realizuar gjithsej 20 inspektime në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Podujevë, Ferizaj dhe Pejë. Si rezultat i inspektimeve, tri lëndë janë dërguar në procedurë, është shqiptuar 1 gjobë, ndërsa në një rast është

bërë edhe sekuestrimi i cigareve, cigareve elektronike dhe produkteve të tjera të ndërlidhura. Inspektimet kanë për qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parandalimin e shitjes së produkteve të duhanit dhe cigareve elektronike në afërsi të

shkollave, veçanërisht për mbrojtjen e të miturve. IQMT do të vazhdojë inspektimet në terren në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës me qëllim të respektimit të ligjit, mbrojtjes së konsumatorëve dhe krijimit të një tregu të sigurt dhe të rregullt.



AVOKATI I POPULLIT: KRITERET E QEVERISË PËR PAGËN E 13 CENOJNË BARAZINË DHE PRITSHMËRINË LEGJITIME

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Avokati i Popullit ka publikuar opinionin lidhur me kriteret e vendosura në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me dhënien e pagës së 13 për të gjithë të punësuarit që marrin pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Përmes këtij opinionit, Avokati i Popullit deklaroi se synon të ofrojë një analizë të përgjithshme të vendimit dhe efekteve të krijuara nga zbatimi i tij, në dritën e respektimit të standardeve juridike që kanë të bëjnë me parimin e barazisë, proporcionalitetit, pritshmërisë legjitime, sigurisë juridike dhe

mbrojtjes së të drejtave të karakterit pasuror, të punonjësve që marrin pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit përmes këtij opinionit vlerëson se përcaktimi normativ i pagës së 13, sikurse ka ndodhur me Ligjin Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në nenin 32, paragrafi 1, krijon pritshmëri legjitime për realizimin e saj si e drejtë subjektive, e karakterit pasuror, e cila ndërlikohet drejtpërdrejt me përcaktimet e nenit 1, protokollit 1 të Konventës



Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Avokati i Popullit thekson se vendimet dhe kriteret administrative, të cilat nxirren për ta jetësuar një normë juridike, nuk mund t'i zvogëlojnë të drejtat të cilat janë të përcaktuara shprehimisht me

ligj, rrjedhimisht nuk mund ta tejkalojnë përcaktimin ligjor dhe të vendosin kriteret e tjera duke iu cenuar subjekteve të drejtat e përcaktuara ligjërisht. Avokati i Popullit konsideron se një veprim i tillë, sikurse ka ndodhur me vendimin 02/07 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, u cenon punonjësve që marrin pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës pritshmërinë legjitime dhe sigurinë juridike, të cilat janë elemente të rëndësishme të sundimit të ligjit. Avokati i Popullit thekson se rregullimi normativ i pagës së 13 duhet të sigurojë barazi mes

përfituesve përmes kriterëve të qarta dhe të arsyeshme ligjore dhe të cilat nuk cenojnë qëllimin për të cilin jepet paga e 13. Avokati i Popullit konsideron se ky opinion mund të shërbejë si këshillë për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, që në rastet e miratimit të akteve lidhur me pagën e 13, ta kenë parasysh gjithëpërfshirjen dhe trajtimin e barabartë për të gjithë punonjësit që i kanë plotësuar kushtet sipas përcaktimeve ligjore lidhur me përfitimin e pagës së 13.

IKD: LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA E ORGANEVE KOLEGJIALE MBETEN PENG I LPPA-SË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në një konferencë për medie mbajtur të enjten publikoi raportin "Llogaridhënia dhe transparenca e organeve kolegjiale, peng i LPPA-së", përmes të cilit trajtohet problemi i mbylljes së mbledhjeve të organeve kolegjiale në institucionet publike. Raporti trajton nenin 39.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), i cili përcakton se mbledhjet e organeve kolegjiale janë të mbyllura, përveç kur legjislacioni në fuqi parasheh ndryshe. Sipas IKD-së, përmes kësaj dispozite mbyllja është vendosur si rregull, ndërsa hapja për publikun si përjashtim. Konferencën e hapi Shqiponjë Gashi, hulumtuese në IKD, e cila theksoi se llogaridhënia nuk lidhet vetëm me publikimin e vendimit përfundimtar apo të procesverbalit, por edhe me mundësinë për të kuptuar se si është zhvilluar diskutimi dhe si është marrë vendimi. Ndërkaq gjetjet e raportit u

paraqitën nga Gzim Shala, hulumtues i lartë në IKD. Ai tha se, në praktikë, nëse një bord apo komision trajton një çështje me interes të lartë publik, por ligji i veçantë nuk e përcakton shprehimisht se mbledhja është publike, mediet, shoqëria civile dhe qytetarët nuk mund ta monitorojnë atë. Sipas Shalës, problemi bëhet edhe më i theksuar për faktin se edhe kur vetë institucioni dëshiron ta hapë mbledhjen, vetëm vullneti për transparencë nuk mjafton. Për sa kohë ligji nuk e lejon hapjen, institucioni rrezikon ta shkelë vetë ligjin. Në raport theksohet se kjo situatë krijon paradoks ligjor. Në njërën anë, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative kërkon administratë të hapur dhe transparente, në anën tjetër për mbledhjet e organeve kolegjiale e vendos mbylljen si parim. Prandaj, raporti gjen se kjo zgjidhje nuk është në harmoni me parimin e administratës së hapur dhe e dobëson orientimin kushtetues drejt transparencës. Sipas IKD-së, qasja në vendim, procesverbal apo dokumente pas përfundimit të mbledhjes nuk e zëvendëson monitorimin



e drejtpërdrejtë të procesit. Në raport theksohet se nga procesverbali mund të kuptohet se çfarë është vendosur, por jo domosdoshmërisht se kush ka kundërshtuar, cilat alternativa janë diskutuar, si është trajtuar ndonjë konflikt potencial interesi, kush e ka propozuar një zgjidhje dhe si është krijuar shumica për një vendim. IKD sqaron se raporti nuk pretendon se çdo mbledhje duhet të jetë e hapur dhe se çdo informacion duhet të bëhet publik. Ka raste kur mbyllja

është e arsyeshme dhe e nevojshme, për shembull kur trajtohen të dhëna personale, informata të klasifikuara, hetime, çështje të sigurisë, sekrete afariste apo interesa të tjera që ligji duhet t'i mbrojë. Megjithatë, sipas IKD-së, logjika aktuale duhet të ndryshojë. Hapja duhet të jetë rregull, ndërsa mbyllja duhet të jetë përjashtim. Për këtë arsye, IKD rekomandon ndryshimin e LPPA-së në dy drejtime: së pari, mbledhjet e organeve kolegjiale duhet të jenë të

hapura për publikun; së dyti, ligji duhet t'i përcaktojë rastet kur një mbledhje ose pjesë e saj mund të mbyllet, pas vlerësimit të dëmit dhe interesit publik dhe me vendim të arsyetuar. Mesazhi kryesor i raportit është se qytetarët nuk duhet ta kenë vetëm të drejtën ta shohin vendimin pasi gjithçka ka përfunduar. Ata duhet, sa herë që nuk ekziston një arsye e ligjshme për mbyllje, të kenë mundësi të shohin edhe se si merret vendimi, kush e merr atë dhe mbi çfarë argumentesh.

SEKUESTROHEN RRETH 10.5 KILOGRAMË NARKOTIKË TË LLOJIT MARIJUANË NË FSHATIN NABËRGJAN TË PEJËS

PEJË, 3 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Pejë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, përkatësisht Njësitin për Luftimin e Narkotikëve në Pejë, njofton opinionin publik se gjatë një operacioni të zhvilluar sot në fshatin Nabërgjan, komuna e Pejës, janë sekuestruar rreth 10 kilogramë e 500 gramë substancë narkotike të llojit marijuanë. Operacioni është zhvilluar në orët e hershme të mëngjesit nga hetuesit e Njësitit për

Luftimin e Narkotikëve në Pejë, të cilët, në kuadër të veprimeve hetimore dhe operative, kanë realizuar sekuestrimin e substancës narkotike. Në vendin e ngjarjes ka dalë edhe prokurori i shtetit nga Departamenti i Krimeve të Rënda i Prokurorisë Themelore në Pejë, i cili ka koordinuar dhe mbikëqyrur veprimet e mëtejshme procedurale. Gjatë operacionit, Policia e Kosovës ka arrestuar një person të dyshuar për veprën penale "Blerja, posedimi,



shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", të përcaktuar sipas

Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Personi i dyshuar është duke u intervistuar nga hetuesit në Stacionin Policor, ndërsa hetimet dhe veprimet e mëtejshme procedurale po vazhdojnë nën udhëzimet dhe koordinimin e prokurorit të shtetit. Gjithashtu, gjatë operacionit është sekuestruar edhe një telefon mobil i cili do të jetë objekt i procedurave të mëtejshme hetimore. Prokuroria Themelore në Pejë

dhe Policia e Kosovës, përkatësisht Njësi i për Luftimin e Narkotikëve në Pejë, mbeten të përkushtuara në luftimin e dukurisë së narkotikëve dhe veprave penale që ndërlikohen me blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të substancave narkotike, duke ndërmarrë veprime të koordinuara hetimore dhe operative me qëllim të parandalimit dhe luftimit të këtyre veprave penale.

ASK dhe Unioni i Turizmit në Kosovë nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për avancimin e statistikave të turizmit

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), e udhëhequr nga drejtori ekzekutiv Avni Kastrati, ka pritur të enjten në takim zyrtar përfaqësuesit e Unionit të Turizmit në Kosovë (UTK), të kryesuar nga kryetari i UTK-së, Baki Hoti, dhe anëtarë të Bordit,

Fisnik Dragusha. Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat, me fokus në përmirësimin e statistikave të turizmit në Kosovë. Takimi u përmbyll me

nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet ASK-së dhe UTK-së, e cila krijon një kornizë të qëndrueshme bashkëpunimi për përmirësimin e raportimit statistikor në sektorin e turizmit; rritjen e vetëdijesimit të bizneseve hoteliere dhe akomoduese për

rëndësinë e raportimit të të dhënave; shkëmbimin e informatave dhe ekspertizës; avancimin e cilësisë, plotësisë dhe kohës së publikimit të statistikave të turizmit. Të dhëna më të plota dhe më cilësore janë bazë për politika më të mira dhe për zhvillim të



qëndrueshëm të turizmit në Kosovë, u tha gjatë nënshkrimit të marrëveshjes.

HAPET ZYRA E PËRBASHKËT E DOGANËS DHE POLICISË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË PRISHTINËS

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës është hapur zyrtarisht Njësia e Përbashkët e Kontrollit (Airport Control Unit - ACU), një strukturë e përbashkët e Doganës së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, e krijuar për forcimin e kontrollit të udhëtarëve dhe ngarkesave dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm. Ceremonia e hapjes u zhvillua me pjesëmarrjen e drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, Policisë së Kosovës përfaqësuar nga Samedin Mehmeti, si dhe përfaqësuesit të UNODC-së, si dhe kreu i bashkëpunimit i Bashkimit Evropian në Kosovë, Hubert Perr, të cilët së bashku hapën zyrtarisht hapësirat e Njesisë së Përbashkët të Kontrollit. Hapja e kësaj njësie shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Doganës dhe Policisë, duke mundësuar koordinim më të drejtpërdrejtë, shkëmbim më



efikas të informacionit dhe veprime të përbashkëta në kontrollin e pasagjerëve dhe ngarkesave në aeroport. Njësia është themeluar në kuadër të Veprimit të Përbashkët BE - UNODC për promovimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të synuara të kontrollit kufitar në portet dhe

aeroportet e Evropës Juglindore - Faza II, i cili zbatohet nga UNODC me partnerë ndërkombëtarë. Projekti synon forcimin e kapaciteteve të autoriteteve të Ballkanit Perëndimor për parandalimin dhe adresimin e krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe terrorizmit

përmes përgjigjeve të koordinuara të institucioneve të zbatimit të ligjit në kufi. Kjo njësi e re e vendos ACU Prishtina në rrjetin rajonal të njësive ndërinstitucionale në Evropën Juglindore, duke krijuar mundësi të reja për shkëmbimin e informacionit dhe inteligjencës, operacione të përbashkëta dhe

shkëmbim të përvojave me njësitë homologe në rajon. Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës mbeten të përkushtuara për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjen e kapaciteteve të kontrollit kufitar, në funksion të sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjes së kufijve të Republikës së Kosovës.

KURTI: 5 700 BIZNESE MË SHUMË DHE MBI 17 MIJË PUNËTORË TË DEKLARUAR KRAHASUAR ME VITIN E KALUAR



PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se rreth 5 700 biznese më shumë dhe mbi 17 mijë punëtorë më shumë të deklaruar, krahasuar me vitin e kaluar. “Sikurse edhe rritje e të hyrave tatimore për rreth 14% dhe e aktiviteteve operative për 35%. Këto janë disa nga treguesit se kemi më shumë aktivitet ekonomik, më shumë vende pune dhe bazë më të gjerë për zhvillimin e vendit. Këto rezultate që Administrata Tatimore e Kosovës po i arrin nuk janë rastësi. Krahas punës

dhe përkushtimit të stafit dhe menaxhmentit, rol të rëndësishëm kanë pasur edhe ndryshimet dhe reformat ligjore të ndërmarrja nga Ministria e Financave, të cilat kanë krijuar bazën e nevojshme për një administratë tatimore më moderne, më efikase dhe më të drejtë”, ka thënë Kurti pas vizitës që i ka bërë ATK-së. Kurti ka thënë se digjitalizimi është një tjetër drejtim ku duhet të vazhdojmë të ecim. “Certifikimi i nëntë kompanive softuerike në procesin e fiskalizimit krijon më shumë

konkurrencë dhe më shumë mundësi për shërbime më të mira dhe më të përballueshme për bizneset. Punësimi i inspektorëve dhe mbledhësve të rinj të borxheve tregon se po ndërtojmë kapacitetet që i nevojiten ATK-së për të ardhmen. Një ekonomi e shëndoshë ka nevojë për një Administratë Tatimore të fortë. Dhe një Administratë Tatimore e fortë ndërtohet me njerëz profesionalë, teknologji moderne dhe besim të ndërsjellë me qytetarët dhe bizneset”, ka theksuar Kurti.

OEK-u në Stamboll: Kosova duhet të jetë pjesë aktive e tregut evropian

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, po merr pjesë në takimin e Komitetit të Anëtarëve të Asociuar dhe Korrespondentë të EUROCHAMBRES, që po mbahet në Stamboll. Në fokus të takimit janë integrimi

ekonomik evropian, zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe përfshirja e vendeve kandidate në Tregun e Vetëm të BE-së. Rafuna theksoi rëndësinë e afritit të bizneseve të Kosovës me tregun evropian, eliminimit të barrierave tregtare dhe forcimit


të bashkëpunimit ndërmjet odave ekonomike. Ai nënvizoi se Kosova dhe sektori privat duhet të kenë rol aktiv në proceset ekonomike evropiane, duke krijuar më shumë mundësi për bizneset, investimet dhe partneritetet ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e OEK-ut në këtë forum forcon përfaqësimin e interesave të bizneseve të Kosovës në rrjetin e EUROCHAMBRES dhe hap mundësi të reja për bashkëpunim dhe qasje më të gjerë në tregjet evropiane.



TI JE PRODUKTI I ALGORITMIT MË TË FUQISHËM QË KA EKZISTUAR NDONJËHERË

Nuk ka programues, nuk ka serverë dhe nuk ka një objektiv të shkruar diku në kod. Ka funksionuar për miliarda vjet, duke prodhuar nga bakteret te balenat, nga dinosaurët te ne. Ti je produkti i algoritmit më të fuqishëm që ka ekzistuar ndonjëherë. Quhet evolucion. Dhe ka një detaj që shpesh e harrojmë: atij nuk i intereson aspak nëse jemi të lumtur.



Kur dëgjojmë sot fjalën “algoritëm”, mendja na shkon pothuajse automatikisht te teknologjia. Te TikTok-u që vendos videon e radhës, Netflix-i që përpiket të kuptojë çfarë filmi do të shohim sonte, Google, Instagrami apo Inteligjenca Artificiale. Por algoritmi më i suksesshëm që njohim nuk është shkruar nga askush. Ka nisur të funksionojë miliarda vjet përpara se të ekzistonte kompjuteri i parë. Në fakt, shumë kohë përpara se të ekzistonte genia e parë njerëzore që mund të mendonte për të. Ai është evolucioni.

Në kuptimin teknik, krahasimi nuk është i përsosur: evolucioni nuk është një program kompjuterik dhe nuk ka një qëllim apo plan të vetëdijshëm. Por si metaforë, ideja është e fuqishme. Nga disa rregulla relativisht të thjeshta, të përsëritura brez pas brezi për një kohë pothuajse të paimagjinueshme, ka dalë gjithë kompleksiteti i botës së gjallë. Dhe ne jemi një prej produkteve të tij. Rregullat bazë janë të njohura. Individët e një specieje nuk janë identikë. Ndodhin ndryshime dhe mutacione. Një pjesë e këtyre ndryshimeve trashëgohen. Në një mjedis të caktuar, disa tipare favorizojnë mbijetesën dhe riprodhimin më shumë se të tjerat. Me kalimin e brezave, ato bëhen më të zakonshme. Pastaj procesi përsëritet e përsëritet pa fund.

Nuk ka një arkitekt që vendos se çfarë duhet të ndërtohet në fund. Megjithatë, nga ky proces kanë dalë sy që dallojnë ngjyrat, krahë që përballojnë fluturime mijëra kilometra, mushkëri, sisteme nervore, truri njerëzor dhe një kafshë që një ditë arriti të ndërtojë teleskopë për të parë fillimet e universit. Dhe këtu historia bëhet shumë më interesante. Sepse evolucioni nuk na ka “projektuar” për të qenë të lumtur.

Produkte të algoritmit: Natyra nuk premtoi kurrë lumturi

Ne kemi prirjen ta shohim trupin dhe mendjen njerëzore sikur të ishin ndërtuar për mirëqenien tonë. Nëse diçka na shkakton ankth, dhimbje apo pakënaqësi, na duket sikur sistemi ka pësuar një defekt. Por natyra nuk funksionon kështu. Përzgjedhja natyrore favorizon tiparet që, në rrethana të caktuara, ndihmojnë organizmat të lënë pasardhës. Jo domosdoshmërisht ato që i bëjnë të ndihen mirë. Dhimbja, për shembull, është e tmerrshme për individin që e përjeton, por jashtëzakonisht e dobishme si alarm. Frika mund të na torturojë, por për paraardhësit tanë aftësia për të reaguar shpejt ndaj një kërcënimi mund të bënte diferencën mes jetës dhe vdekjes.

Edhe prirja jonë për të kërkuar vazhdimisht diçka më shumë ka kuptim nga kjo perspektivë. Imagjini dy paraardhës tanë. Njëri gjen ushqim të mjaftueshëm dhe mendon: Më mjafton. Jam plotësisht i kënaqur. Tjetri, edhe pasi ka ngrënë, vazhdon të kërkojë ushqim, burime, status, partnerë dhe siguri. Në një botë ku dimri i ardhshëm mund të sillte uri, kënaqësia e përhershme nuk ishte domosdoshmërisht avantazh. Pakënaqësia po.

Kjo mund të shpjegojë një paradoks që e njohim shumë mirë edhe sot: marrim atë që kemi dashur dhe, pas pak kohe, mendja fillon të kërkojë objektivin tjetër. Punën tjetër. Shtëpinë tjetër. Udhëtimin tjetër. Rritjen tjetër të pagës. Edhe një mijë ndjekës. Edhe një sukses. Nuk është se brenda nesh ekziston një buton që, pasi arrijmë një nivel të caktuar, shtypet dhe thotë: mjaft, tani je i lumtur përgjithmonë. Po të ekzistonte, ndoshta paraardhësit tanë nuk do të kishin shkuar shumë larg.

Problemi është se bota ndryshoi më shpejt se ne

Trupi dhe truri ynë mbajnë ende gjurmët e një bote shumë të ndryshme nga ajo ku jetojmë sot. Për pjesën dërrmuese të historisë njerëzore, sheqeri dhe yndyra ishin burime të çmuara energjie. T'i kërkoje kishte kuptim. Sot mund t'i porosisësh nga divani dhe të të

mbërrijnë te dera brenda pak minutash.

Truri që dikur shpërblente gjetjen e ushqimit kalorik tani gjendet përballë supermarketit, fast food-it dhe aplikacioneve të shpërndarjes. E njëjta gjë ndodh me vëmendjen. Për një kafshë sociale si njeriu, të dije se çfarë mendonin të tjerët për ty kishte rëndësi të jashtëzakonshme. Përjashtimi nga grupi dikur mund të kishte pasoja shumë serioze për mbijetesën. Sot ky mekanizëm i lashtë përballlet me një ekran ku mund të shohim, në kohë reale, sa njerëz na pëlqejnë, sa na ndjekin, kush na ka parë dhe kush nuk ka reaguar.

Teknologjia është e shekullit XXI, por një pjesë e mekanizmave tanë emocionale janë shumë më të vjetër. Dhe këtu fshihet një mënyrë interesante për të kuptuar shumë nga kontradiktat tona. Ne kemi ndërtuar një qytetërim që mund të na japë më shumë rehati, ushqim, informacion dhe argëtim sesa do të kishte imagjinuar një mbret disa shekuj më parë. Megjithatë, makina biologjike që merr të gjitha këto nuk është krijuar për të thënë: Tani kam gjithçka dhe mund të ndalem. Ajo vazhdon të kërkojë.

Sot flasim me shqetësim për algoritmet që po mësojnë të na njohin. Algoritmi i rrjetit social mëson se çfarë na zemëron. Platforma e videove mëson se çfarë na mban edhe tridhjetë sekonda para ekranit. Reklamuesit mësojnë se çfarë na tndon. Inteligjenca Artificiale po bëhet

gjithnjë e më e aftë të parashikojë se çfarë duam. Ama të gjitha këto sisteme po punojnë mbi një platformë shumë më të vjetër. Mbi vetë ne!

Mbi dëshirat, frikërat, impulset, xhelozitë, kuriozitetin dhe nevojën për miratim që nuk lindën me internetin. Në njëfarë mënyre, algoritmet moderne nuk i shpikën dobësitë tona. Ato thjesht mësuam t'i lexojnë jashtëzakonisht mirë. Dhe kjo e ndryshon pak mënyrën se si mund ta shohim veten.

Ndoshta nuk jemi krijesa racionale që herë pas here pengohen nga instinktet. Ndoshta jemi krijesa të formuara nga miliona vjet instinkte, që relativisht vonë mësuam të arsyetojmë për to. Kjo nuk do të thotë se jemi të burgosur prej biologjisë sonë. Përkundrazi.

Sepse evolucioni prodhoi edhe diçka të pazakontë: një tru të aftë të kuptojë, të paktën pjesërisht, procesin që e krijoi. Ne mund ta dallojmë impulsin pa qenë të detyruar ta ndjekim. Mund të vendosim se çfarë do të hamë edhe kur trupi kërkon më shumë. Mund të refuzojmë statusin, konkurrencën apo aprovimin e grupit. Mund të vendosim që suksesi ynë nuk do të matet vetëm me atë që biologjia shpërblen. Evolucioni nuk ka nevojë që ne të jemi të lumtur. Por ne kemi një avantazh që pjesa më e madhe e jetës në Tokë nuk e ka: mund ta dimë këtë. Pikërisht aty fillon liria jonë. / bota.al

SHËRBIMET IZRAELITE TRUMPIT: ‘IRANI DO TË TË VRASË, JA PLANI’

Nëse iranianët do të arrinin vërtet ta vrisnin, siç shkroi Wall Street Journal duke zbuluar se izraelitët ua kishin kaluar amerikanëve planet e Teheranit për një atentat kundër Trumpit, presidenti tashmë i ka lënë urdhrat Pentagonit që «t’i bombardojë në nivele që nuk i kanë parë kurrë më parë». Në të njëjtën kohë, megjithatë, ai thotë se SHBA-ja ka pranuar kërkesën e Teheranit për të vazhduar negociatat 60-ditore të parashikuara nga memorandumit i mirëkuptimit, edhe pse e konsideron «armëpushimin të përfunduar». Qëndrimet e marra dhe nga presidenti duken kontradiktore, por ndoshta ato janë pjesë e strategjisë së tij të zakonshme për ta rritur presionin në maksimum, në mënyrë që të marrë atë që kërkon; të themi të drejtën, kjo strategji deri tani nuk ka pasur sukses të madh me ajatollahët.

Bombardimet e ndërsjella u shkaktuan nga interpretimet e ndryshme mbi mënyrën e rihapjes së Ngushticës së Hormuzit, nën kontrollin ose jo

të Teheranit, por në orët e fundit ato janë bërë aq të rënda, sa të ngjallin frikën e rifillimit të luftës. Kësaj iu shtua edhe zbulimi i Wall Street Journal, sipas të cilit shërbimet izraelite i kishin informuar homologët amerikanë për një komplot iranian për të vrarë Trumpin. Gazeta nuk dha hollësi, por vetë kreu i Shtëpisë së Bardhë kishte folur për këtë gjatë konferencës për shtyp në përfundim të samitit të NATO-s në Ankara.

Më pas, për t’u kthyer në shtëpi, ai hoqi dorë nga përdorimi i avionit të ri Air Force One të dhuruar nga Katari, teorikisht për t’ua treguar trupave amerikane të dislokuara në Gjermani, por ndoshta edhe sepse ai është më i goditshëm, pasi nuk ka mbrojtjet raketore me të cilat ishte pajisur modeli i mëparshëm.

Në të vërtetë, komploti për të vrarë Trumpin nuk është një lajm befasues, sepse intelijenca amerikane kishte zbuluar tashmë plane për të vrarë sekretarin e Shtetit Pompeo dhe këshilltarin për sigurinë kombëtare Bolton, që



tani të dy kanë dalë kundër Trumpit. Do të ishte e çuditshme që iranianët të mos kishin menduar diçka të ngjashme edhe kundër presidentit, pas eliminimit të komandantit të Pasdaranëve, Qasem Soleimani.

Në fakt, Trumpi, ndoshta për të hedhur poshtë dyshimin se është kryeministri izraelit Netanyahu ai që po e shtyn drejt luftës, deklaroi për New York Post: «Jo, jo. Izraeli nuk ka prodhuar asgjë. Unë kam qenë numri një (në listën e armiqve

të Iranit) prej shumë kohësh. Kështu është jeta.»

Më pas ai shpjegoi se si është përgatitur: «Kam lënë udhëzime që, nëse ndodh diçka, t’i bombardojnë fjalë për fjalë në nivele që nuk i kanë parë kurrë më parë.»

Pak më parë, megjithatë, duke komentuar në rrjetet sociale rifillimin e përplasjeve, ai kishte publikuar këtë mesazh: «Republika Islamike e Iranit na ka kërkuar të vazhdojmë bisedimet. Ne kemi pranuar, por Shtetet e Bashkuara u kanë

deklaruar atyre, pa lënë vend për keqkuptime, se armëpushimi ka përfunduar.» Teherani ka mohuar se ka kërkuar rikthimin në tryezën e negociatave; për këtë arsye, tani SHBA-ja dhe Irani ecin mbi një fije të hollë, të pezulluar mes rifillimit të negociatave dhe luftës. Deri në zgjedhjet e mesmandatit kanë mbetur më pak se katër muaj dhe, për këtë arsye, Trumpi nuk ka interes për një përshkallëzim që do të ishte shumë jopopullor edhe mes vetë mbështetësve të tij MAGA, për të mos folur për të gjithë votuesit e tjerë, të goditur sërish nga rritja e çmimit të naftës dhe inflacioni.

Nuk është rastësi që, sipas CNN, administrata nuk dëshiron që Izraeli të përfshihet në sulmet e këtyre ditëve, nga frika se veprime të tilla mund të provokojnë rifillimin e luftës në shkallë të gjerë. Megjithatë, askush nuk mund ta përjashtojë mundësinë që vetë Trumpi, ose ndoshta një incident, ta bëjnë gjithsesi të pashmangshme përplasjen.

MBI 2 MIJË PERSONA NË STËRVITJEN MË TË MADHE TË MBROJTJES CIVILE NË EVROPË QË NGA LUFTA E DYTË BOTËRORE

Më shumë se 2,000 njerëz në Finlandë, përfshirë vullnetarë dhe studentë, po marrin pjesë në stërvitjen më të madhe të mbrojtjes civile në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Skenari, i zbuluar nga Associated Press, parashikon që infrastruktura kritike në qytetin qendror finlandez të Kuopio-s, përfshirë rrjetet e energjisë elektrike dhe të ujit, të goditet nga sulme kibernetike. Në të njëjtën kohë, ekziston një kërcënim për sulme me raketa nga Rusia fqinje. Qëllimi i ushtrimit është që si autoritetet lokale, ashtu edhe qytetarët e zakonshëm, të testojnë në praktikë se si do të reagonin në rast të një sulmi të vërtetë. Si pjesë e ushtrimit, një shpellë në Kuopio po transformohet në një hapësirë të sigurt për mijëra njerëz. Brenda saj, në një hapësirë që normalisht funksionon si palestër sportive, qindra qytetarë kalojnë natën në shtretër të palosshëm.

Bunkerët nëntokësorë mund të ofrojnë njëfarë mbrojtjeje nga raketat, por jo nga fushata e sabotimit dhe destabilizimit që zyrtarët perëndimorë thonë se Rusia po zhvillon në të gjithë Evropën.

Këto veprime përfshijnë zjarrvënie të qëllimshme, sulme ndaj termocentraleve dhe centraleve energjetike, si dhe dërgimin e dronëve në hapësirën ajrore të Bashkimit Evropian për qëllime sabotimi.

Kufiri i Finlandës me Rusinë shtrihet për më shumë se 1,300 kilometra, nga Deti Baltik deri në Rrethin Arktik. Në vitin 2024, Finlanda iu bashkua NATO-s, së bashku me Suedinë, pas pushtimit

në shkallë të plotë të Ukrainës nga Vladimir Putin. Deri atëherë, finlandezët ishin përgatitur të mbroheshin kundër Rusesë – kryesisht vetë.

Mbrojtja e Finlandës, sipas kolonelit në pension Asko Muhonen, i cili foli për Associated Press, bazohet jo vetëm në forcat e armatosura, por edhe në “mentalitetin” e qytetarëve të zakonshëm, të cilët janë të gatshëm të marrin përgjegjësinë për sigurinë e vendit të tyre.

Muhonen, i cili organizoi stërvitjen në Kuopio, shpjegoi se ky mentalitet është pjesërisht i lidhur me sistemin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, i cili u mbajt në Finlandë edhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik.

“Jo të gjithë janë të lumtur të kryejnë shërbimin e tyre, por është detyra jonë të shërbejmë dhe të mbrojmë këtë vend, siç bënë ata para nesh. Kjo është arsyeja pse kemi pavarësinë tonë”, i tha AP-së rekruti Yuri Pietikainen, 23 vjeç, i cili u trajnuar për të drejtuar strehën gjatë natës.

Finlanda duhet të mësojë gjithashtu nga përvoja e Ukrainës, argumentoi Muhonen.

Streha më e madhe në Kuopio mund të akomodojë 7,000 njerëz. Megjithatë, në Ukrainë, qytetarët shpesh kanë vetëm pak minuta për të vrapuar drejt një stacioni metroje ose një parkingu nëntokësor.

Kjo do të thotë se qytetarët kanë nevojë për strehimore që janë lehtësisht të arritshme dhe ofrojnë njëfarë mbrojtjeje, pa qenë domosdoshmërisht të projektuara për t’i bërë ballë një sulmi bërthamor.

Dmytro Udila, një student 20-vjeçar ukrainas në Universitetin e Kuopio-s, ishte në shtëpi në Odesa kur raketat ruse goditën qytetin më 24 shkurt 2022, ditën e parë të luftës. Ai tha se u detyrua të strehohej në hyrjen e ndërtesës së tij të apartamenteve, sepse nuk kishte ku të shkonte tjetër. Trajnimi për një situatë të tillë me siguri do ta kishte ndihmuar Ukrainën, tha ai, “sepse askush nuk e dinte se diçka e tillë mund të ndodhte”.

Kërcënimin më të madh për infrastrukturën energjetike në rajonin e Kuopio-s mbeten reshjet e dendura të borës, stuhitë dhe moti ekstrem, tha për AP-në Juha Rasanen, drejtor ekzekutiv i kompanisë energjetike Savon Voima.

Por që nga pushtimi i Ukrainës dhe vendimi i kompanisë për të ndaluar blerjen e biokarburanteve ruse, numri i sulmeve kibernetike në rrjet është rritur ndjeshëm.

Vitin e kaluar, inxhinierët gjetën të paktën 10 afishe të vendosura në vende veçanërisht të cenueshme të infrastrukturës energjetike. Afishe të ngjashme janë gjetur edhe nga kompani të tjera energjetike në Finlandë, por nuk është përcaktuar se kush i ka vendosur ato.

“Nëse do të kishte një shpërthim në atë pikë, një digë e tërë mund të shkatërrohej”, pranoi Rasanen.

Dronë janë parë gjithashtu duke fluturuar mbi linjat e energjisë, por autorët nuk janë identifikuar. Nuk është e mundur të mbrohesh nga çdo kërcënim, tha ai. Për këtë arsye, është e rëndësishme që qytetarët të jenë të përgatitur të mbrohen vetë për të paktën 72 orë,



nëse ndërpritet energjia elektrike ose uji bëhet i pasigurt për konsum.

Agjencia Finlandeze e Sigurisë dhe Inteligjencës tha se kishte hetuar “një gamë të gjerë vëzhgimesh”, pa gjetur asgjë shqetësuese.

Ajo shpjegoi se që nga viti 2022, qytetarët janë bërë më të kujdesshëm për shkak të situatës së sigurisë dhe po raportojnë incidente të tilla si ngjitëset reflektuese, të cilat mund të lidhen me punën e matjeve. Pamjet e dronëve, sipas agjencisë, “janë shpjeguar kryesisht nga incidentet e përditshme”.

“Gjëra të vogla ndodhin gjatë gjithë kohës”, përfshirë ndërhyrjen ruse në sinjalet GPS, tha Vuko Lahtinen, 32 vjeç, për AP-në, ndërsa vizitoi një sauna në Kuopio. Kjo është arsyeja pse, tha ajo, “mbrojtja më e mirë e Finlandës është të bëjë një sulm të pafitimprurës”. Kjo varet nga forcat ushtarake dhe mbrojtëse të vendit, por edhe nga vetë finlandezët, të cilët mendojnë se “kanë diçka për të cilën ia vlen të luftohet”.

Në Finlandë, shpjegoi ajo, ekziston një “ndjenjë e përgjithësuar

përgjegjësie”, e cila është zhvilluar përmes komuniteteve lokale dhe madje edhe iniciativave si riciklimi.

“Në një nivel shumë të thjeshtë, të përditshëm, nëse bën gjëra që kanë rëndësi, atëherë ekziston një efekt fluturë”, shtoi ajo.

Mijëra njerëz kaluan nëpër strehën e Kuopio-s, përfshirë nxënës shkollë dhe studentë universiteti.


“Fëmijët duhet të dinë çfarë të bëjnë sepse mund t’u duhet të reagojnë vetë. Të rriturit nuk mund të ndihmojnë gjithmonë”, tha 11-vjeçarja Amanda Hill, shkolla e së cilës i mbajti mësimet në strehë për atë ditë.

I ulur në dyshe me rekrutë të tjerë, Pietikainen shpjegoi pse nuk mendon se praktikimi i skenarëve të krizës është i tepërt.

“Ne jemi finlandezë, kështu që jemi disi pesimistë për jetën”, tha ai. Por historia tregon se çfarë mund të ndodhë me Rusinë.

Kur bëhet fjalë për kërcënimet nga Moska, Muhonen e përmbloodhi qëndrimin finlandez në një fjali:

“Mos u besoni atyre që thonë. Shikoni se çfarë bëjnë.”



Kosova mbyll 'Taranto 2026' me rekord medaljesh

TARANTO, 3 SHTATOR - Republika e Kosovës ka përmbyllur pjesëmarrjen në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026" me nëntë medalje, duke vendosur rekord të ri në historinë e pjesëmarrjes së saj në këto gara. Bilanci i Kosovës përfshin dy medalje të arta, tri të argjendta

dhe katër të bronzta. Medaljet e arta janë fituar nga boksierja Donjeta Sadiku dhe karateisti Islam Selmani. Në mesin e medalistëve të Kosovës janë edhe xhudistët Laura Fazliu, Akil Gjakova, Shpati Zekaj, Fatjona Kasapi dhe Flaka Loxha, si dhe peshëngritësi

Kianoush Rostami. Megjithatë, vëmendja e kësaj të enjten ka qenë te "Prishtina 2030". Gjatë ceremonisë së mbylljes së Lojërave Mesdhetare në Taranto, flamuri i është dorëzuar Kosovës, e cila do të jetë nikoqire e edicionit të ardhshëm të Lojërave

Mesdhetare, që do të zhvillohen në Prishtinë në vitin 2030. Kështu, Kosova jo vetëm që e ka përmbyllur "Taranto 2026" me një bilanc rekord medaljesh, por ka marrë zyrtarisht në dorëzim organizimin e edicionit të ardhshëm të këtyre garave.



KOSOVA MERR VLERËSIM TË VEÇANTË NGA FIFA, ARSENE WENGERI FALËNDERON FFK-në

PRISHTINË, 3 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka pranuar një letër falënderimi dhe vlerësimi nga shefi i zhvillimit global të futbollit në FIFA, Arsene Wenger, në të cilën ai ka shprehur mirënjohje për angazhimin dhe përkushtimin e federatës në themelimin e "FIFA Talent Academy Kosova". Në letrën drejtuar presidentit të FFK-së, Agim Ademi, Wengeri ka vlerësuar bashkëpunimin dhe punën e bërë nga federata në prag të themelimit të kësaj akademie, duke e cilësuar përkushtimin e FFK-së si thelbësor për avancimin e kësaj nisme. "Përkushtimi juaj i palëkundur ka qenë thelbësor në avancimin e kësaj nisme. Event i historik i mbajtur në Prishtinë është dëshmi e profesionalizmit tuaj, përsosmërisë organizative dhe pasionit për zhvillimin e futbollit", është thënë në letrën e Wengerit. Ai ka theksuar se



eventi i organizuar në Prishtinë nuk ishte vetëm një festë për këtë arritje, por edhe një moment frymëzues për të gjithë aktorët e përfshirë në zhvillimin e futbollit. Wenger ka vlerësuar veçanërisht mbështetjen dhe burimet e ofruara nga FFK-ja gjatë gjithë procesit, duke nisur nga



harmonizimi me standardet e FIFA-s e deri te prezantimi i vizionit të akademisë. Sipas tij, këto përpjekje dëshmojnë rolin e rëndësishëm të Kosovës në zhvillimin dhe kultivimin e talenteve të futbollit, ndërsa njëkohësisht mund të shërbejnë si standard edhe për vendet e tjera.

LETRA E PLOTË:

"FIFA Talent Academy Kosova": Faleminderit për përpjekjet dhe bashkëpunimin tuaj të jashtëzakonshëm

I nderuar president,
Në emër të FIFA-s, dëshiroj t'ju shpreh falënderimet tona të përzemërta juve dhe të gjithëve në federatën tuaj për përkushtimin shembullor dhe bashkëpunimin e treguar në prag të themelimit të "FIFA Talent Academy Kosova". Përkushtimi juaj i palëkundur ka qenë thelbësor në avancimin e kësaj nisme. Event i historik i mbajtur në Prishtinë është dëshmi e profesionalizmit tuaj, përsosmërisë organizative dhe pasionit për zhvillimin e futbollit. Ajo nuk ishte vetëm një festë e kësaj arritjeje të jashtëzakonshme, por edhe një moment frymëzues për të gjithë aktorët e përfshirë. Ne e vlerësojmë jashtëza-

konisht shumë mbështetjen dhe burimet që keni ofruar gjatë gjithë këtij procesi, nga harmonizimi me standardet e FIFA-s e deri te prezantimi i vizionit tuaj gjatë eventit. Përpjekje të tilla e vënë në pah rolin kyç të Kosovës në zhvillimin dhe kultivimin e talenteve të futbollit, si dhe në vendosjen e një standardi për vendet e tjera. Me kënaqësi presim që ta forcojmë edhe më tej partneritetin tonë, ndërsa ecim përpara në këtë kapitull të ri dhe emocionues. Së bashku, mund të vazhdojmë të ndërtojmë një trashëgimi të qëndrueshme për futbollin në Kosovë dhe më gjerë. Edhe një herë, ju falënderojmë për përkushtimin dhe kontributin tuaj të jashtëzakonshëm për t'i dhënë çdo talenti në Kosovë një mundësi.

*Me respekt,
Arsene Wenger
Shef i zhvillimit global të futbollit*

PRISHTINA - VUSHTRRIA HAPIN XHIRON E KATËRT TË SUPERLIGËS



Edhe xhiron e katërt e Superligës së Kosovës në futboll do të zhvillohet përgjatë tri ditëve. Për dallim prej tri xhironve paraprake, orari i ndeshjeve prej xhiros së katërt do të ndryshojë pasi ato do të fillojnë 30 minuta më herët. Pra, të gjitha, pesë përballjet e xhiros së katërt të Superligës, do të startojnë nga ora 16:00. Ndeshja hapëse e

kësaj xhironje do të jetë ajo ndërmjet Prishtinës dhe Vushtrrisë, e cila do të luhet sot (e premtë) në kampin nacional të FFK-së, në Hajvali. Sigurisht, Prishtina llogaritet favorit në këtë duel, duke pasur parasysh se Vushtrria në tri ndeshje të zhvilluara prejse është rikthyer në Superligë ka regjistruar po aq humbje. Prishtina ka dy fitore nga po aq

ndeshje dhe ndaj Vushtrrisë synon triumfin e radhës për ta konfirmuar formën e mirë që e ka treguar deri më tani. Ndërkohë, duelet e tjera të xhiros së katërt janë: Drita - Drenica e Llapi - Dukagjini që luhen nesër (e shtunë) dhe Malisheva - Gjilani e Ballkani - Feronikeli '74, që zhvillohen pasnesër (e diel).

Korenica largohet nga Cluj, firmos me Steaua Bukureshtin

BUKURESHTI, 3 SHTATOR - Meriton Korenica ka ndërruar ekip, por jo edhe kampionat, pasi karrierën do ta vazhdojë në futbollin e Rumanisë. Ai është larguar nga skuadra e Clujit për t'u transferuar te FCSB (Steaua Bukureshti), pasi një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga

drejtuesit e të dyja klubeve. Steaua do të paguajë 600 mijë euro për kartonin e Korenicës, i cili me ekipin e ri do të firmosë kontratë trevjeçare dhe do të ketë pagë mujore prej 30 mijë eurosh. Korenica 29-vjeçar, pritet së shpejti të paraqitet te skuadra e

re, me të cilën synon suksese në vazhdim të karrierës. Ai ishte një prej lojtarëve kryesorë të Clujit dhe ndër mesfushorët më të vlerësuar në kampionatin rumun. Te Steaua e vlerësojnë Korenicën si përforcim të madh, kurse futbollisti nga

Kosova me ekipin e ri mund të debutojë këtë vikend, saktësisht të shtunën në derbin ndaj Dinamo Bukureshtit. Korenica ishte pjesë e Clujit prej vitit 2024 dhe me këtë skuadër ka regjistruar 11 paraqitje, duke shënuar 27 gola dhe bërë 11 asistime.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU “ALI HADRI” - PRIŠTINA

Datë: 04.09.2026

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) nën 24 dhe 35, Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024) nën 21 dhe 33, nën 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Rregullores Nr.01/31/24 date 31.01.2025 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë nën 4,11, Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më: 03.09.2026 shpall:

KONKURS

1. Konkurs për zgjedhje dhe rizgjedhje në titujt shkencorë për këto vende pune:

(1) Këshilltar shkencor për periudhën osmane. (zgjedhje)

(1) Këshilltar shkencor për shek. XIX-XX. (zgjedhje)

(2) Bashkëpunëtor të lartë shkencor për periudhën bashkëkohore shek. XX. (zgjedhje)

Kandidatët/ja për Këshilltar shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

— Të ketë gradën e doktorit të shkencave.

— Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencorë për fushën (periudhën historike) që dëshmohet.

— Të ketë dy (2) vepra shkencore monografike, një pas zgjedhjes së fundit dhe dy (2) vëllime me dokumente, një pas zgjedhjes së fundit, nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe akademitë e shkencave.

— Më së paku pesë (5) punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

— Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.

— Përvojë së paku në dy (2) projekte kërkimore-shkencore, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale.

— Afërsi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

Kandidatët/ja për Bashkëpunëtor të lartë shkencor duhet t'i plotësojë këto kushte:

— Të ketë gradën e doktorit të shkencave.

— Të tregojë nivel të lartë kompetence e përvojë shkencore për fushën (periudhën historike) që dëshmohet.

— Të ketë një (1) veprë shkencore monografike pas zgjedhjes së fundit dhe një (1) vëllim me dokumente pas zgjedhjes së fundit nga periudha përkatëse, të botuara nga institucionet kërkimore-shkencore, institucionet e arsimit të lartë dhe akademitë e shkencave.

— Të ketë më së paku 3 punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante ndërkombëtare nga periudha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

— Të ketë pjesëmarrje aktive së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.

— Përvojë së paku në një (1) projekt kërkimorë-shkencore, të realizuara nga institucionet kërkimore-shkencore dhe profesionale.

— Afërsi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

— Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse.

— Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas akteve në fuqi.

— Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj.

— CV-të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

— Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit shkencor dhe hulumtues të Institutit të Historisë “Ali Hadri” bëhet në pajtim me dispozitat në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nën 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, “Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve” dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetatat ditore, si dhe në faqen e internetit të Institutit të Historisë “Ali Hadri”.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen dhe protokollohen në administratën e Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, në adresën Eqrem Qabej nr. 111.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU “ALI HADRI” - PRIŠTINA

Datum: 04.09.2026. godine

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02. maj 2013. godine), članova 24 i 35, Statuta Instituta za istoriju „Ali Hadri“ Priština (01B-195, od 31.10.2024. godine), članova 21 i 33, člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Pravilnika br. 01/31/24 od 31.01.2025. godine o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, članova 4 i 11, Naučno veće Instituta za istoriju „Ali Hadri“ Priština, na sednici održanoj dana 03.09. 2026. godine, objavljuje:

KONKURS

1. Konkurs za izbor i reizbor u naučna zvanja za sledeća radna mesta:

(1) Naučni savetnik za osmanski period. (Izbor)

(1) Naučni savetnik za period XIX-XX veka. (Izbor)

(2) Viši naučni saradnik za period XX veka. (Izbor)

Kandidati/kinje za naučnog savetnika moraju ispunjavati sledeće uslove:

— Da imaju zvanje doktora nauka.

— Da pokažu visok nivo kompetentnosti i naučnog iskustva za oblast (istorijski period) koja se dokazuje.

— Da imaju dve (2) naučne monografske publikacije, jednu nakon poslednjeg izbora, i dva (2) toma sa dokumentima, jedan nakon poslednjeg izbora, iz odgovarajućeg perioda, objavljena od strane naučno-istraživačkih institucija, visokoškolskih ustanova i akademija nauka;

— Najmanje pet (5) naučnih radova objavljenih u relevantnim međunarodnim naučnim časopisima iz odgovarajućeg perioda, od kojih dva (2) nakon poslednjeg izbora, i da je uspešno učestvovao/la u organizovanju naučno-istraživačke delatnosti;

— Da ima aktivno učešće na najmanje tri (3) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna;

— Iskustvo u najmanje dva (2) naučno-istraživačka projekta, realizovana od strane naučno-istraživačkih i stručnih institucija;

— Sposobnost za rukovođenje naučno-istraživačkim i akademskim projektima.

Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik moraju ispunjavati sledeće uslove:

— Da ima zvanje doktora nauka.

— Da pokaže visok nivo kompetentnosti i naučnog iskustva u oblasti (istorijskom periodu) koji se dokazuje.

— Da ima jedno (1) monografsko naučno delo nakon poslednjeg izbora i jedan (1) tom sa dokumentima nakon poslednjeg izbora iz odgovarajućeg perioda, objavljene od strane naučnoistraživačkih institucija, visokoškolskih ustanova i akademija nauka.

— Da ima najmanje tri (3) naučna rada objavljena u relevantnim međunarodnim naučnim časopisima iz odgovarajućeg perioda, od kojih su dva (2) objavljena nakon poslednjeg izbora, kao i da je uspešno učestvovao/la u organizovanju naučnoistraživačke delatnosti.

— Da ima aktivno učešće na najmanje dve (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna.

— Iskustvo na najmanje jednom (1) naučnoistraživačkom projektu, realizovanom od strane naučnoistraživačkih i stručnih institucija.

— Sposobnost za rukovođenje naučnoistraživačkim i akademskim projektima.

Potrebna dokumentacija

Kandidat/kinja treba da dostavi sledeću dokumentaciju:

— Diplomu o završenim odgovarajućim studijama.

— Diplome stečene u inostranstvu moraju biti nostrifikovane u skladu sa važećim aktima.

— Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci.

— CV uz koji treba priložiti potrebne dokaze za potvrđivanje stanja navedenog u njemu.


— Dokaze o naučnim dostignućima (članci, knjige, itd.).

Izbor naučnog i istraživačkog osoblja Instituta za istoriju „Ali Hadri“ vrši se u skladu sa odredbama na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno-istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02. maj 2013. godine), Statuta Instituta za istoriju „Ali Hadri“ - Priština (01B-195, od dana 31. oktobra 2024. god.), člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, „Pravilnika o postupcima izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača“ i drugih relevantnih akata Instituta.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednim dnevnim novinama, kao i na internet stranici Instituta za istoriju „Ali Hadri“.

Uz prijavu se prilažu kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koju zahteva radno mesto za koje konkurišu.

Popunjene prijave se dostavljaju i protokolišu u administraciji Instituta za istoriju „Ali Hadri“ u Prištini, na adresi Eqrem Qabej br. 111.



SHML “ Xhevdet Doda” - Prishtinë
Nr.prot.16-580/2026
Data.03.09.2026

FTESË PËR OFERTË

Gjimmazi “Xhevdet Doda” – Prishtinë fton të gjithë operatorët ekonomikë/bizneset e interesuara që të paraqesin ofertat e tyre për: FURNIZIM ME USHQIM, UJË DHE PIJE PËR BUFENË E SHKOLLËS

I. KUSHTET DHE KËRKESAT

Operatori ekonomik duhet të sigurojë ushqim dhe produkte të freskëta, të sigurta dhe të përshtatshme për konsum, duke respektuar të gjitha kushtet higjieno-sanitare, kërkesat ligjore në fuqi dhe rregullat e institucionit shkollor.

Operatori ekonomik është përgjegjës për ruajtjen, përgatitjen, ngrohjen dhe shërbimin e ushqimit, në përputhje me standardet dhe kërkesat për sigurinë ushqimore.

Të gjitha produktet duhet të jenë të cilësisë së përshtatshme për konsum dhe të kenë afat të vlefshëm përdorimi, sipas natyrës së produktit.

II. PRODUKTET DHE OFERTA

- A. Ushqime të cekura në oferte
- B. Pije freskuese
- C. Pije të nxehta
- D. Ëmbëlsira dhe produkte të tjera

VËREJTJE

- Nxënësve nuk u shërbehet kafë.
- Pijet energjike janë të ndaluara në ambientet e bufësë së shkollës.
- Produktet ushqimore duhet të jenë të freskëta, të sigurta dhe të përshtatshme për konsum.
- Operatori ekonomik duhet të respektojë të gjitha rregullat higjieno-sanitare dhe rregullat e institucionit shkollor.

III. HAPËSIRA E BUFESË

Hapësira e bufësë që do të shfrytëzohet nga operatori ekonomik është **262 m²**.

Çmimi i shfrytëzimit të hapësirës duhet të jetë së paku **2,00 € për m² në muaj**.

Operatori ekonomik ka për obligim ta pajisë bufenë me:

- Pajisje për ruajtjen dhe ngrohjen e ushqimit;
- Pajisje dhe mjete të tjera të nevojshme për funksionimin e rregullt të bufësë;
- Pajisje të përshtatshme për ruajtjen dhe prezantimin e produkteve ushqimore.

Operatori ekonomik është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e hapësirës së bufësë gjatë gjithë kohës së shfrytëzimit.

Bufeja duhet të jetë e hapur çdo ditë pune, nga e hëna deri të premten, prej orës 07:30 deri në 19:00.

IV. KËRKESAT PËR OPERATORIN EKONOMIK

Operatorët ekonomikë të interesuar duhet të dëshmojnë:

- Minimum 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në veprimtari të ngjashme;
- Referencë/rekomandim nga së paku një institucion, kompani ose klient për shërbime të ngjashme;
- Dëshmi/referencë për përvojë në ofrimin e shërbimeve të ngjashme në shkolla ose institucione të tjera arsimore, nëse posedon;
- Certifikatën e biznesit;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Vërtetimin tatimor me numër fiskal;
- Certifikatën dhe/ose dokumentacionin përkatës të sanitarisë;
- Dokumentacionin tjetër të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

Personeli i angazhuar në bufe duhet:

- Të posedojë dokumentacionin/certifikatën përkatëse shëndetësore;
- Të jetë i pajisur me uniformë pune;
- Të mbajë bexh/kartë identifikuese;
- Të respektojë kërkesat higjieno-sanitare;
- Të respektojë rregullat dhe udhëzimet e institucionit shkollor.

V. PËRMBAJTJA E OFERTËS FINANCIARE

Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën financiare me çmimet për secilin produkt:

Nr.	Emërtimi i produktit	Njësia	Çmimi (€)
1	Byrek me djathë	copë	
2	Byrek me mish	copë	
3	Byrek me spinaq	copë	
4	Xhevrek	copë	
5	Pica	copë	
6	Sandviç	copë	
7	Hamburger	copë	
8	Chicken Burger	copë	
9	Hot Dog	copë	
10	Tost	copë	
11	Kiflë me xhem	copë	
12	Kiflë me salsiçe	copë	
13	Kiflë me djathë	copë	
14	Kiflë me eurokrem	copë	
15	Tortilla me mish pile	copë	
16	Tortilla me perime	copë	
17	Pomfrit	porcion	
18	Nuggets pile	porcion	
19	Palaçinka	copë	
20	Kroasan me mbushje	copë	
21	Kanaqe të ndryshme	copë	
22	Top Joy 0.33 l	copë	
23	Top Joy 0.20 l	copë	
24	Jogurt	copë	
25	Pije në shishe 0.50 l, pa gaz	copë	
26	Ujë 0.50 l, pa gaz	copë	
27	Makiato e madhe – mbi 18 vjeç	copë	

28	Makiato e vogël – mbi 18 vjeç	copë
29	Kapuçino – mbi 18 vjeç	copë
30	Ekspres – mbi 18 vjeç	copë
31	Neskafe – mbi 18 vjeç	copë
32	Çokollatë e nxehtë	copë
33	Çajra të ndryshëm të nxehtë	copë
34	Çokollata të ndryshme	copë
35	Çips	copë
36	Muffin	copë
37	Pite me mollë	copë

Çmimi për shfrytëzimin e hapësirës së bufësë: **2€ / m² në muaj**.

VI. DORËZIMI I OFERTAVE

Operatorët ekonomikë të interesuar duhet t'i dorëzojnë ofertat e tyre në Gjimmazin “Xhevdet Doda” – Prishtinë, në një zarf/pliko të mbyllur, nga data 04.09.2026 deri më 10.09.2026, nga ora 09:00 : deri në 15:00.

Mbi zarfin/plikon e mbyllur duhet të shënohet:

“OFERTË PËR FURNIZIM ME USHQIM, UJË DHE PIJE PËR BUFENË E SHKOLLËS”

Ofertat do të pranohen dhe hapen nga komisioni për pranimin dhe vlerësimin e ofertave, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga institucioni.

VII. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, Komisioni do të përzgjedhë ofertën më të favorshme, duke marrë parasysh:

- Përvojën e operatorit ekonomik në veprimtari të ngjashme;
- Përvojën dhe referencat e ofruara për shërbime të ngjashme në shkolla ose institucione të tjera arsimore;
- Cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve;
- Kushtet higjieno-sanitare;
- Pajisjet dhe investimet që operatori ekonomik merr përsipër;
- Kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit.
- Vlerësimi në çmimin e produkteve.

Shënim: Përmbushja e kërkesave dhe dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar është kusht për shqyrtimin e ofertës.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bellaqa Construction” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812029131 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bellaqa Construction” D.O.O. Fushë Kosovë donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812029131 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Bellaqa Construction” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812029131 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bellaqa Construction” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812029131 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bellaqa Construction” D.O.O. Fushë Kosovë donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812029131 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Bellaqa Construction” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812029131 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

